

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kafe Shqeto - 'Saranda po monopolizohet tek të pushtetshmit', Qurku: Po sillen njerëz për ta shkatërruar e kriminalizuar
ADRESA	https://www.syri.net/politike/916705/saranda-po-monopolizohet-tek-te-pushtetshmit-qurku-po-sillen-njerez-per-ta-shkaterruar-e-kriminalizuar/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 07:00:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 06:36:26 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0f355e8f22cb8b1b96482dfa7bb8c561874b37dc421ba492803d6d2ed1c442ca
TEKSTI	50574b60fe8b83fca444bbe81b791c06cdd65ad09072d631f212ab0a65815099
PAMJA	4f6ebb6200c7c06da08771489a4e8c3897350aa1565dd7b74d57c908dbe88c99

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3f42bb17d94f29e688067606110f4e8134c842f1b8f6e4d219ec5799021c9e00
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	144dcc84d15b7d80530ccf1620af6bb24eccd27028b717aa2669aa241970dde3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3f42bb17d94f29e688067606110f4e8134c842f1b8f6e4d219ec5799021c9e00>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




IRENA BEQIRAJ

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



AGIM XHAFKA

Dialog me mbesën



‘Saranda po monopolizohet tek të pushtetshmit’, Qurku: Po sillen njerëz për ta shkatërruar e kriminalizuar

08:36, 15/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Saranda, e njohur dikur si një nga qytetet më të bukura bregdetare të Shqipërisë, duket se ka rënë pre e një transformimi të errët.

E ftuar në ‘Kafe Shqeto’, kryetarja e PD, Matilda Qurku shprehet se referuar ngjarjeve të fundit, qyteti turistik është shndërruar në një vatër të kimit të organizuar, duke regjistruar shkallën më të lartë të kriminalitetit në vend, pavarësisht popullsisë së ulët.

Sipas saj, ky nuk është një fenomen i rastësishëm, por një projekt i mirëmenduar nga strukturat qeverisëse për ta përqendruar kontrollin e qytetit në pak duar.

Asetet kryesore të qytetit, nga bregdeti te Porti i Jahteve (Marina), peshkimi, arsimi dhe shëndetësia, raportohet se u janë dhënë oligarkëve dhe personave me precedentë të sjellë nga qytete të tjera.

Për Qurkun, ndarja e këtyre pasurive publike ngre dyshime të forta për afëra korruptive dhe lidhje të thella politike, paai qëllimi pas këtij monopolizimi dyshohet të jetë asfiksioni i hapësirave publike dhe ekonomisë vendase, duke e përdorur varfërimin dhe shantazhin e qytetarëve si instrument për të siguruar vota gjatë periudhave zgjedhore.



Në fakt Saranda nga qyteti i vogël, i bukur dhe magjik i turizmit, është kthyer siç tha dhe kryeprokurori në kriminalitetin më të lartë. Popullsia më e ulët me kriminalitetin më të lartë. Dhe kjo tregon qartë se çfarë po ndodh në Sarandë. Në fakt do doja sot këtu të flisja për një Sarandë të zhvilluar, me turizëm që po shkëlqen, por nuk është kështu. Saranda është kthyer në çerdhen e kimit, Saranda është kthyer në duart e kimit të organizuar, fatkeqësisht. Dhe Saranda është bërë kryefjalë e lajmeve të zeza. Fatkeqësisht kjo nuk është prej qytetarëve të Sarandës, por është prej atyre që na imponojnë edhe na i sjellin ata që qeverisin. Nëse do bësh një bilanc të gjithë drejtuesve të mëdhenj në Sarandë, që kanë në dorë fatin e këtij qyteti, asnjë nuk është nga Saranda, asnjë nuk ka lidhje me Sarandën. Kjo tregon qartë se sjellin njerëz të importuar nga jashtë, për ta shkatërruar, për ta prishur Sarandën dhe për të bërë atë që ata duan.

më të lexuarat




Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin



‘Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama’, Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre



Shqiptari nga Anglia: Rama dha urdhër të mos hyjmë në shesh! Të rimë këtu derisa ta shporrim nga zyra antishqiptarin



‘Diaspora nuk ka për t’ia falur Ramës! Shqiptarët e bashkuar pushteti i tmerruar! Dita e 105 e protestës në foto



Urimi dhe mesazhi i Metës: PISA janë një tjetër dëshmi e gjendjes alarmante të shkollave! Për PL-në arsimit prioritet



SPAK merr nën hetim deputetin e PD, Luan Baçi, Noka: Sulm politik i orkestruar nga mercenarët e narko-rilindjes



Saranda po i nënshtrohet krimit. Është fatkeqësi kjo Flavio, por është një e vërtetë që duhet thënë sepse nëse nuk flasim të vërtetat, atëherë ato bëhen probleme edhe të mëdha. Kështu që çfarë dreqin po bëhet në Sarandë? Po sillen njerëz që ta shkatërrojnë Sarandën.

Nuk ndodhi rastësisht ë, nuk doli dikush nga një qytet tjetër, përgjithësisht Fieri në vitet e fundit, që të thotë që unë dua një tokë apo një ndërtim në Sarandë edhe i jepet. I jepet me synimin e qartë, që ti do marrësh këtë gjë, por për të na ndihmuar ne ta shkatërrojmë Sarandën. Dhe si shkatërrohet Saranda? Duke i marrë të gjitha pushtetet në Sarandë dhe duke bërë çdo gjë të mundshme që mos të ngelet as hapësirë, as ajër... as ajër mos të ngelet në Sarandë, që sarandjoti, ai i devotshëm që e do këtë vend e do të zhvillohet, mos të ketë asnjë mundësi. Kjo e thënë në politikë, le ta kthejmë kështu, është e qartë që kthehet në vota. Kthehet në vota, kthehet në presion ndaj qytetarit, që pushteti të vazhdojë të mbajë pushtetin, duke i kërcënuar qytetarët, duke i shantazhuar ata dhe duke i blerë votat siç i kemi parë të gjitha kohët edhe vitet e fundit në zgjedhje. Prandaj, çdo gjë bëhet me synim, nuk bëhet kot.

Si funksionon. Si kudo në Shqipëri, thjesht në Sarandë duke qenë një vend më i vogël ka edhe një bum më të madh. Të gjitha sektorët në Sarandë, jo vetëm turizmi, po të gjitha sektorët, u janë dhënë njerëzve që kanë pushtet. Janë dhënë në oligarkë edhe u janë dhënë për afëra të pastra korruptive. Ju jeni e dijeni... koshient që ne kemi port, Marinën, që është dhënë, është sekuestruar nga SPAK-u si gjë por vazhdon të jetë... një pjesë duke u ndërtuar, duke bërë baza në det. Kemi peshkimin që po ashtu porti i peshkimit është duke u diskutuar për t'u dhënë... në fakt nuk është dhënë, edhe nuk është bërë publike. Kemi shëndetësinë, arsimin, në turizmin, pra kudo, politika është dhënë oligarkëve. Ndërkohë që, dakord, çfarë është duke bërë opozita? Ne si opozitë jemi duke mbledhur të gjitha faktet, jemi duke denoncuar përditë, jemi duke ushtruar presion por jemi këtu për qytetarët e për të thënë të vërtetat.

Prandaj është një marrëdhënie shumë e komplikuar dhe unë do të doja ta cilësoja vërtet si një organizatë e mirëfilltë kriminale, që ka hapur tentakulat e tij jo më në Sarandë por dhe në fshatrat përreth. Dhe situata është ajo që duket prej kaq vitesh nga opozita. Në Shqipëri duhet që të veprojnë instancat e larta. Pra, SPAK-u nuk duhet të merret më me gjëra të vogla. Ndiq paranë, është shumë e thjeshtë. Ndiq paranë, shihe që ai ka marrë një rrogë të thjeshtë, si mund të bëhet biznesmen i suksesshëm ku i gjeti? Ndërkohë që biznesmenë shumë të fuqishëm kanë arritur drejt falimentimit. Pra, ja kaq e thjeshtë është, që ti nëse do të punosh edhe ta bësh këtë vend, ndiq paranë edhe e gjen se ku është korrupsioni dhe është shumë e thjeshtë për të shkuar lart. Poshtë ndodh përditë dhe bëhet.

Thjesht duan më tepër se ç'kanë. Edhe janë sektorë... e domethënë, ta themi thjesht. Policia është për të ndaluar qytetarin e thjeshtë që lyen muret e shtëpisë, nuk është për të ndaluar shitjen e... e mallrave të ndaluar apo për të ndaluar krimin. Ju patë pak më parë në lajme që u arrestua një i shumëkërkuar i SPAK-ut gabimisht. Se po ta dinin që ishte ai, nuk e ndalonin. E ndaluan, i thanë që ishte në timon, e shoqëruan kur morën vesh kush ishte s'kishin çfarë t'i bënin. Kështu që në Sarandë jo se nuk... nuk e bëjnë dot. Nuk duan ta bëjnë në sektorë dhe në vende të caktuara. Ne kemi një polici që rreh një të arrestuar në mes të qytetarëve. Kjo tregon forcë, sepse e nxjerrin në momentin, kushdo qoftë nuk dua të merrem me rastin konkret edhe të vendos fajtor ose jo, por po flas për imazhin që u tregua.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Mbyllet protesta e 107-të, qytetarët: Rama jepe dorëheqjen



Rama çan me thonj pasagjerin, reagon Berisha: Dënoj me forcën më të madhe dhunën brutale të Padrinos



VIDEO-Përgjimi i Roni Yeffet/ Abilekaj: Flet për armë nga Sudani, kjo i heq licencën. Ku shkuan 30 mln euro?

Canon lirinë e medias, Rregullorja e Brendshme e GJKKO-së përfundon në Gjykatë Kushtetuese


Shqiptarja nga Venecia: Rama kriminel!
Nuk jemi popull dele, në shesh shoh luanë e luanesha

'Diktatorët s'ikin duhen hequr' Shqiptarja nga Franca: Nuk është normale që presidenti nuk reagon kur rinia është në rrugë

TË NGJASHME



Këlliçi: Roni i Ramës paska të gjithë qeverinë në dorë!



Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Reuters: Vendimi mund të tronditë raportet e Kosovës me Perëndimin



'Rama ka ndërtuar gjithçka', Saraçi: Përgjimi lidh Ballukun me skemën e Timak Defense



VIDEO-Delvina Gas/ Yeffet instruktin ukrainasit dhe rusët: Shkoni në Vlorë dhe thoni se përfaqësoni një kompani amerikane



VIDEO/ Hoxha: Balluku shkoi vetë te Delvina Gas me gjithë kupolën e institucioneve dhe udhëhoqi aksionin e bllokimit



'Divjaka e qytetarëve, jo e tradhtarëve!'/ Banorët vijojnë protestën e 46-të kundër shkrirjes së bashkisë



Skandali 'KAYO', Hoxhaj: U dhanë 30 milionë euro nga buxheti i shtetit për makina të salduara në një kaponon

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIË ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.